

# AQ sound FS S

## Udhëzuesi i aparatit të dëgjimit

AQ sound FS S  
AQ sound FS S myChoice  
Karikuesi HANSATON S



**HANSATON**  
*hearing & emotions*



Ky udhëzues përdorimi vlen për modelet e mëposhtme

### **Aparatet e dëgjimit**

**CE**  
**0459**

AQ sound FS 9-S

AQ sound FS 7-S

AQ sound FS 5-S

AQ sound FS 3-S

AQ sound FS S myChoice



### **Aksesori i karikimit jo me valë**




**CE**



Karikuesi HANSATON S



## Detajet e aparatit të dëgjimit dhe të karikuesit

-  Nëse nuk është zgjedhur asnjë kuti dhe nuk e dini modelin e aparatit tuaj të dëgjimit ose të aksesorëve të karikimit, pyesni audiologun tuaj.
-  Aparatet e dëgjimit të përshkruara në këtë udhëzues përdorimi përfshijnë një bateri të rikarikueshme të integruar dhe që nuk hiqet me jone litiumi.
-  Lexoni gjithashtu informacionet e sigurisë në lidhje me trajtimin e aparateve të rikarikueshme të dëgjimit (kapitulli 24).

### Modelet e aparateve të dëgjimit

- AQ sound FS S (9/7/5/3)
- AQ sound FS S myChoice

### Kufjet

- Gominë
- SlimTip

### Aksesori i karikimit

- Karikuesi HANSATON S



## Faleminderit

---

Faleminderit që keni zgjedhur këto aparate dëgjimi. Lexoni me kujdes udhëzuesin e përdorimit për t'u siguruar që t'i kuptoni dhe të përfitoni sa më shumë nga aparatet tuaja të dëgjimit. Për manovrimin e kësaj pajisjeje nuk kërkohet ndonjë trajnim. Një audiolog do t'ju ndihmojë për konfigurimin e pajisjeve të dëgjimit sipas preferencave tuaja individuale gjatë këshillimit për shitjet / vendosjes.

Për më shumë informacion në lidhje me veçoritë, përfitimet, konfigurimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen ose riparimet e aparatit të dëgjimit dhe aksesoreve që vijnë bashkë me të, kontaktoni me audiologun tuaj ose me përfaqësuesin e prodhuesit. Informacione të mëtejshme mund të gjenden në skedën e specifikimeve të produktit tuaj.



## Tabela e përmbajtjes

1. Udhëzuesi i shpejtë.....	2
2. Pjesët e aparatit të dëgjimit dhe të karikuesit.....	4
3. Përgatitja e karikuesit.....	8
4. Karikimi i aparateve të dëgjimit.....	10
5. Shenjat e aparatit të dëgjimit majtas dhe djathtas .....	13
6. Vendosja e aparateve të dëgjimit në veshë.....	14
7. Heqja e aparatit të dëgjimit nga veshi.....	15
8. Butoni me shumë funksione.....	16
9. Ndezja/fikja .....	20
10. Kontrolli me prekje .....	21
11. Përmbledhje e lidhjeve .....	22
12. Përmbledhje e aplikacionit HANSATON stream remote .....	23
13. Çiftimi i aparateve të dëgjimit me një pajisje .....	24
14. Telefonatat .....	26
15. Modaliteti i fluturimit .....	31
16. Rindezja e aparatit të dëgjimit .....	33
17. Kushtet për përdorimin, transportin dhe ruajtjen .....	34
18. Kujdesi dhe mirëmbajtja .....	36
19. Ndërrimi i mbrojtëses për dyllin e veshit .....	40
20. Shërbimi dhe garancia.....	44
21. Informacioni i pajtueshmërisë.....	46
22. Informacion dhe shpjegimi i simboleve .....	51
23. Udhëzuesi i zgjidhjes së problemeve.....	55
24. Informacione të rëndësishme për sigurinë.....	60
Aparati për reduktimin e tinitusit .....	81


## 1. Udhëzuesi i shpejtë

### Paralajmërimi për bateri të ulët



2 tinguj bip çdo  
30 minuta


### Butoni me shumë funksione



### Ndezja/fikja e aparateve të dëgjimit


Shtypni dhe mbani shtypur butonin në secilin aparat dëgjimi për 3 sekonda derisa dritat treguese të ndryshojnë. Aparati i dëgjimit është konfiguruar që të ndizet automatikisht kur hiqet nga karikuesi.

**I ndezur:** Drita treguese është përkohësisht e gjelbër e qëndrueshme



Ndezur

**I fikur:** Drita treguese është përkohësisht e kuqe e qëndrueshme



Fikur

**i** Përpara përdorimit të aparateve të dëgjimit për herë të parë rekomandohet t'i karikoni për 3 orë.

### Karikimi i aparateve të dëgjimit

Vendosni aparatet e dëgjimit në karikues.

**Duke u karikuar:** Drita treguese pulson ngadalë

**Të karikuar plotësisht:** Drita treguese është e gjelbër qëndrueshme




e

## Shenjat e aparatit të dëgjimit majtas dhe djathtas

**Shenja L për aparatit e dëgjimit majtas.**

**Shenja R për aparatit e dëgjimit djathtas.**





## Aktivizoni modalitetin e fluturimit

Kur pajisja është e fikur, vazhdoni të shtypni butonin për 7 sekonda. Drita treguese do të pulsojë fillimisht në ngjyrë të gjelbër dhe pastaj do të bëhet portokalli e qëndrueshme, gjë që tregon se modaliteti i fluturimit është aktivizuar.



## Kontrolli me prekje

Nëse çiftohet me një pajisje që e ka të aktivizuar Bluetooth, mund të hyni në shumë funksione duke përdorur kontrollin me prekje, referojuni kapitullit 10. Për të përdorur kontrollin me prekje, prekni dy herë majën e veshit tuaj.




## 2. Pjesët e aparatit të dëgjimit dhe të karikuesit

---


- 1 **Drita treguese** - tregon gjendjen e karikimit të baterisë dhe kur aparati i dëgjimit ndizet/fiket
  - 2 **Mikrofonat** - tingulli hyn në aparatet e dëgjimit nëpërmjet mikrofonave
  - 3 **Butoni me shumë funksione** - funksionon si një çelës për ndezjen/fikjen, kalon mes programeve të dëgjimit, ndryshon nivelin e volumit dhe pranon ose refuzon telefonatat e telefonit në varësi të konfigurimit tuaj të personalizuar
  - 4 **Teli** – lidh njësinë e altoparlantit me aparatet tuaja të dëgjimit
  - 5 **Gomina** - mban njësinë e altoparlantit në kanalën e veshit
  - 6 **Njësia e altoparlantit** - amplifikon tingullin dhe e dërgon direkt në kanalën e veshit
  - 7 **Aksesorit mbajtës** - ndihmon për parandalimin e daljes së gomës dhe të njësisë së altoparlantit nga kanali i veshit
  - 8 **Kontaktet e karikimit**
- 
- 




## Aparatet e dëgjimit AQ sound FS S



## Karikuesi HANSATON S




Foletë e karikimit të  
apararit të dëgjimit me  
treguesit majtas/djathtas




Lidhja USB-C me burim  
të jashtëm energjie  
Drita treguese për  
energjinë

## Burimi i jashtëm i energjisë



Kabllo USB (≤ 3 m)



Ushqyesi\*

\*Ushqyesi mund të mos jepet bashkë me këtë produkt. Mund të përdoret çdo ushqyes me specifikimet e mëposhtme.


## Specifikimet e ushqyesit

Voltazhi hyrës i furnizimit me energji	100-240 VAC, 50/60 Hz, rryma 0,25 A
Voltazhi dalës i furnizimit me energji	5 VDC +/-10%, rryma 1 A
Voltazhi hyrës i karikuesit	5 VDC +/-10%, rryma 500 mA
Specifikimet e kablos USB	5 V min. 1 A, USB-A në USB-C, gjatësia maksimale 3 m

### 3. Përgatitja e karikuesit

#### Lidhja e ushqyesit

- Vendosni skajin më të madh të kabllot së karikimit tek ushqyesi.
- Vendosni skajin më të vogël në portën USB të karikuesit.
- Vendoseni ushqyesin në prizë elektrike.
- Drita treguese është e gjelbër kur karikuesi është i lidhur me prizën elektrike.



Karikuesi mund të përdoret me një burim të jashtëm të energjisë që plotëson specifikimet në tabelën në faqen e mëparshme (faqja 7).





- ① Nivel i ulët i energjisë: Do të dëgjoni dy tinguj bip kur bateria të jetë në nivel të ulët. Do të keni rreth 60 minuta përpara se t'ju duhet t'i karikoni aparatet e dëgjimit (kjo mund të ndryshojë në varësi të cilësimeve të aparatit të dëgjimit).
- ① Aparati i dëgjimit përfshin një bateri të rikarikueshme të integruar dhe që nuk hiqet me jone litiumi.
- ① Përpara përdorimit të aparatit të dëgjimit për herë të parë rekomandohet ta karikoni për 3 orë.
- ① Aparati i dëgjimit duhet të jetë i thatë përpara vendosjes në karikim.
- ① Sigurohuni ta karikoni dhe ta përdorni aparatin e dëgjimit brenda diapazonit të temperaturës së funksionimit: +5° deri +40° celsius (41° deri në 104° fahrenheit).



## 4. Karikimi i aparateve të dëgjimit


### Përdorimi i karikuesit

1. Futni aparatet e dëgjimit në fole të karikimit. Sigurohuni që shënimet e aparatit të dëgjimit majtas dhe djathtas të përputhen me treguesit pranë foleve të karikimit.
2. Drita treguese e aparatit të dëgjimit do të tregojë gjendjen e karikimit të baterisë derisa aparati i dëgjimit të karikohet plotësisht. Kur të karikohet plotësisht, drita treguese do të qëndrojë e ndezur, d.m.th. me dritë të gjelbër të qëndrueshme.



Procesi i karikimit ndalon automatikisht pas karikimit të plotë të baterive, kështu që aparatet e dëgjimit mund të lihen pa problem në karikues. Mund të nevojiten deri në 3 orë për karikimin e aparateve të dëgjimit. Kapaku i karikuesit mund të mbyllet gjatë karikimit.

3. Hiqni aparatet e dëgjimit nga foletë e karikimit thjesht duke i ngritur ato nga karikuesi.







- ⓘ Mos i mbani telat për t'i hequr aparatet e dëgjimit nga karikuesi, pasi mund të dëmtoni telat.
- ⓘ Fikni aparatën e dëgjimit para se ta vendosni në karikuesin e shkëputur për ta ruajtur atë.

Aparati i dëgjimit do të ndizet automatikisht kur të hiqet nga karikuesi. Drita treguese fillon të pulsojë.

Drita e gjelbër e qëndrueshme tregon se aparati i dëgjimit është gati për përdorim.

Nëse e hiqni karikuesin nga priza ndërkohë që aparati i dëgjimit po karikohet brenda, sigurohuni që të fikni aparatin e dëgjimit për të parandaluar shkarkimin.

Për ta fikur karikuesin, hiqni ushqyesin nga priza elektrike.


Drita treguese	Gjendja e karikimit	Kohët e përafërta të karikimit
	0 – 10%	
	11 – 80%	30 min (25%) 60 min (50%) 90 min (75%)
	81 – 99%	
	100%	3 orë



## 5. Shenjat e aparatit të dëgjimit majtas dhe djathtas

Ka një shenjë L/R në pjesën e poshtme të aparatit të dëgjimit dhe një shenjë të kuqe ose blu në altoparant. Kjo do t'ju tregojë nëse është aparati i dëgjimit për anën e majtë apo të djathtë.

- Shenja L/blu për aparatit e dëgjimit majtas.
- Shenja R/e kuqe për aparatit e dëgjimit djathtas.






### Etiketimi

Numri i serisë dhe viti i prodhimit ndodhen në pjesën e pasme të pajisjes. Ai është shënuar me lazer në trupin e jashtëm.


## 6. Vendosja e aparateve të dëgjimit në veshë

1. Vendosni aparatin e dëgjimit pas veshit.
2. Mbajeni telin aty ku vendoset te gomina dhe shtyjeni lehtë gominën në kanal tuaj të veshit. Teli duhet të jetë i mbështetur në kokën tuaj dhe jo të dalë jashtë.
3. Nëse ka një pjesë mbajtëse, vendoseni në vesh në fund të vrimës së kanalit të veshit.




## 7. Heqja e aparatit të dëgjimit nga veshi

1. Tërhiqni pjesën e harkuar të telit dhe hiqni aparatin e dëgjimit nga prapa veshit.



## 8. Butoni me shumë funksione

Butoni me shumë funksione ka disa funksione. Ai funksionon si një çelës për ndezjen/fikjen, si kontroll volumi dhe/ose për ndryshimin e programit në varësi të programimit të aparatit të dëgjimit.



Nëse aparati i dëgjimit çiftohet me një telefon që e ka të aktivizuar Bluetooth®, një shtypje e shkurtër në buton do të pranojë një telefonatë hyrëse dhe një shtypje e gjatë do të refuzojë një telefonatë hyrëse.

## □ **Kontrolli i programeve**

Nëse butoni me shumë funksione është për kontrollin e programeve, sa herë që të shtypni butonin në një nga aparatet e dëgjimit për më shumë se 2 sekonda, do të kaloni në programin pasues të aparatit të dëgjimit.

Aparatet e dëgjimit lëshojnë një tingull bip për të treguar se në cilin program jeni.

Vendosja e programit	Tingujt bip
Programi 1 (p.sh. program automatik)	♪ 1 tingull bip
Programi 2 (p.sh. të folurit në zhurmë)	♪♪ 2 tinguj bip
Programi 3 (p.sh. telefon)	♪♪♪ 3 tinguj bip
Programi 4 (p.sh. muzika)	♪♪♪♪ 4 tinguj bip

## **Kontrolli i volumit**

Nëse butoni me shumë funksione është konfiguruar për kontrollin e volumit:



- Shtypni butonin në aparatën e dëgjimit djathtas për të rritur volumin dhe
- Shtypni butonin në aparatën e dëgjimit majtas për të ulur volumin

ose:

- Shtypni butonin për të kaluar nëpër nivelet e volumit

Kur ndryshoni volumin, aparatet e dëgjimit lëshojnë një tingull bip.


Vendosja e volumit	Tingujt bip
Niveli i sugjeruar i volumit	♪ 1 tingull bip
Ngritja e volumit	♪ tingull i shkurtër bip
Ulja e volumit	♪ tingull i shkurtër bip
Niveli maksimal i volumit	♪♪ 2 tinguj bip
Niveli minimal i volumit	♪♪ 2 tinguj bip





**Butoni me shtypje i kontrollit të programit/  
volumit**

Nëse audiologu ka konfiguruar një aparat dëgjimi që të jetë për kontrollin e programit dhe aparat tjetër që të jetë për kontrollin e volumit:

- Shtypni butonin në aparatin e dëgjimit  djathtas /  majtas për të aksesuar programe të ndryshme dhe
- Shtypni butonin në aparatin e dëgjimit  djathtas /  majtas për të kaluar ndërmjet niveleve të volumit




 Këto udhëzime përshkruajnë cilësimet e paracaktuara të butonit me shumë funksione ose të kontrollit me prekje. Audiologu juaj mund t'i ndryshojë funksionet. Konsultohuni me audiologun tuaj për më shumë informacione.



## 9. Ndezja/fikja



### Ndezja e aparatit të dëgjimit

Aparati i dëgjimit mund të caktohet që të ndizet automatikisht kur hiqet nga karikuesi. Nëse ky funksion nuk është konfiguruar, shtypni fort dhe mbani të shtypur butonin derisa drita treguese të pulsojë. Prisni derisa drita e gjelbër e qëndrueshme të tregojë se aparati i dëgjimit është gati.



### Fikja e aparatit të dëgjimit

Mbani të shtypur butonin derisa drita treguese të bëhet e kuqe e qëndrueshme, gjë që tregon se aparati i dëgjimit është i fikur.

	E gjelbër pulsuese	Aparati i dëgjimit po ndizet
	E kuqe e qëndrueshme	Aparati i dëgjimit po fiket

- ① Kur i ndizni aparatet e dëgjimit mund të dëgjoni një melodi të nisjes.






## 10. Kontrolli me prekje

---


Nëse çiftohet me një pajisje që e ka të aktivizuar Bluetooth, mund të përdorni shumë funksione duke përdorur kontrollin me prekje, si p.sh. të pranoni/mbyllni telefonatat, të vendosni në pauzë/vazhdoni transmetimin, të nisni/ndaloni asistentin zanor.

Për të përdorur kontrollin me prekje, prekni dy herë majën e veshit tuaj.



## 11. Përmbledhje e lidhjeve

Ilustrimi më poshtë tregon disa nga opsionet e lidhjeve që ofrohen për aparatet tuaja të dëgjimit.



Për më shumë informacione, shikoni udhëzuesin e përdorimit që vjen me aksesoren tuaj. Kontaktoni me audiologun tuaj për të marrë një TV Connector, Remote Control ose aksesorë PartnerMic ose Roger.

\* TV Connector mund të lidhet me çdo burim audio, si p.sh. televizorin, kompjuterin ose një sistemi hi-fi.



## 12. Përmbledhje e aplikacionit HANSATON stream remote

---

### Informacionet e përputhshmërisë

Aplikacioni HANSATON stream remote mund të përdoret në telefonat me aftësinë Bluetooth Low Energy (LE). Gjeni detajet për përputhshmërinë e telefonit në:

**[hansaton.com/support](https://hansaton.com/support)**

Gjeni udhëzimet për përdorimin në

**[hansaton.com/user-guides](https://hansaton.com/user-guides)**



Instaloni aplikacionin HANSATON stream remote për përdoruesit e iPhone, skanoni kodin:



Instaloni aplikacionin HANSATON stream remote për përdoruesit e Android OS, skanoni kodin:



iPhone® është një markë tregtare e Apple Inc., e regjistruar në SHBA dhe në shtete të tjera. iOS® është një markë tregtare e regjistruar ose markë tregtare e Cisco Systems, Inc. dhe/ose filialet e saj në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera të caktuara. Android™ është një markë tregtare e Google LLC.




## 13. Çiftimi i aparateve të dëgjimit me një pajisje

### Çiftimi fillestar me një pajisje që e ka të aktivizuar Bluetooth®

1. Në pajisjen tuaj (d.m.th. telefoni), shkoni te menyja e cilësimeve për t'u siguruar që Bluetooth është aktiv dhe kërkoni për pajisjet që e kanë të aktivizuar Bluetooth.



2. Ndizni të dyja aparatet e dëgjimit. Aparatet tuaja të dëgjimit do të qëndrojnë në modalitet çiftimi për 3 minuta.

3. Pajisja juaj shfaq një listë të pajisjeve që e kanë të aktivizuar Bluetooth.





Zgjidhni aparatin e dëgjimit nga lista për t'i çiftuar njëkohësisht të dyja aparatet e dëgjimit. Një tingull bip konfirmon çiftimin e suksesshëm.

Bluetooth® është një markë tregtare e regjistruar në pronësi të Bluetooth SIG, Inc.

- 
- 
- ① Procedurën e çiftimit mjafton ta kryeni vetëm një herë me çdo telefon që e ka të aktivizuar Bluetooth. Pas çiftimit fillestar, aparatet e dëgjimit do të lidhen automatikisht me pajisjen. Çiftimi fillestar mund të zgjasë deri në 2 minuta.
  - ① Konsultohuni me udhëzuesin e përdorimit të telefonit për udhëzime mbi çiftimin e tij me një pajisje Bluetooth.

### Lidhja me pajisjen


Pasi aparatet e dëgjimit të jenë çiftuar me pajisjen tuaj, ato do të lidhen përsëri automatikisht kur të ndizen.

- 
- 
- ① Lidhja do të ruhet për sa kohë që telefoni qëndron i ndezur dhe brenda një rrezeje deri në 10 m (30 ft).
  - ① Aparatet e dëgjimit mund të lidhen me deri në dy pajisje dhe të çiftohen me deri në tetë pajisje.

## 14. Telefonatat

Aparatet e dëgjimit lejojnë komunikim të drejtpërdrejtë me pajisjet që mbështesin lidhjen me Bluetooth. Kur çiftohen dhe lidhen me një telefon, do të dëgjoni njoftimet, njoftimet e telefonatave hyrëse dhe zërin e telefonuesit direkt në aparatet tuaja të dëgjimit. Aparatet e dëgjimit e marrin zërin tuaj përmes mikrofonave të tyre.

- ① Nuk ka nevojë ta mbani telefonin celular pranë gojës, zëri juaj përcillet nga aparatet e dëgjimit drejt telefonit celular.





## Kryerja e telefonatave


Niseni telefonatën në telefonin tuaj celular të çiftuar siç do ta bënit normalisht. Shkruani numrin e telefonit dhe shtypni butonin e telefonatës. Do të dëgjoni tonin e formimit të numrit dhe audion përmes aparateve të dëgjimit. Zëri juaj merret nga mikrofonat e aparateve të dëgjimit dhe transmetohet në telefon.



## Pranimi i telefonatave


Kur merrni një telefonatë, do të dëgjoni njoftimin e telefonatës hyrëse në aparatet e dëgjimit.

Telefonata mund të pranohet duke prekur dy herë majën e veshit tuaj, ose me një shtypje të shkurtër prej më pak se 2 sekondash në butonin me shumë funksione në një nga aparatet e dëgjimit. Përndryshe, pranojeni telefonatën në telefon si normalisht.



prekni veshin  
dy herë

ose




shtypje e shkurtër  
< 2 sek




## Mbyllja e telefonatave

Një telefonatë mund të mbyllet duke prekur majën e veshit tuaj dy herë, me një shtypje të gjatë prej më shumë se 2 sekondash në butonin me shumë funksione në aparatin e dëgjimit, ose direkt në telefon.



prekni veshin  
dy herë


ose



shtypje e gjatë  
> 2 sek

## Refuzimi i telefonatave

Një telefonatë hyrëse mund të refuzohet me një shtypje të gjatë në butonin me shumë funksione në një nga aparatet e dëgjimit për më shumë se 2 sekonda. Përndryshe, refuzojeni telefonatën direkt në telefonin tuaj.





shtypje e  
gjatë  
> 2 sek

## 15. Modaliteti i fluturimit

Aparatet tuaja të dëgjimit funksionojnë në diapazon frekuencash 2,4–2,48 GHz. Kur jeni në fluturim, disa operatorë kërkojnë që të gjitha pajisjet të kalohen në modalitetin e fluturimit. Hyrja në modalitet fluturimi nuk e çaktivizon funksionin normal të aparatit të dëgjimit, por vetëm funksionet e lidhjes me Bluetooth.

### Hyrja në modalitet fluturimi


Për të hyrë në modalitetin e fluturimit, ndiqni hapat e mëposhtëm për të dyja aparatet e dëgjimit më vete:

1.		Nëse aparati i dëgjimit është i fikur, vazhdoni me hapin 2. Nëse aparati i dëgjimit është i ndezur, fiken duke mbajtur shtypur butonin derisa drita treguese të bëhet e kuqe e qëndrueshme, gjë që tregon se aparati i dëgjimit po fiket.
2.		Vazhdoni të shtypni butonin për 7 sekonda. Drita treguese do të pulsojë fillimisht në ngjyrë të gjelbër dhe pastaj do të bëhet portokalli e qëndrueshme, gjë që tregon se modaliteti i fluturimit është aktivizuar.

Në modalitetin e fluturimit, aparatet e dëgjimit nuk mund të lidhen direkt me telefonin tuaj.

### **Dalja nga modaliteti i fluturimit**

Për të aktivizuar funksionin e lidhjes me valë Bluetooth dhe për të dalë nga modaliteti i fluturimit: Fikni aparatin e dëgjimit dhe më pas ndizeni përsëri.







## 16. Rindezja e aparatit të dëgjimit

---

Përdorni këtë teknikë nëse aparati i dëgjimit tregon një gabim. Kjo nuk do të heqë ose të fshijë asnjë program apo cilësim.

1. Shtypni butonin për të paktën 15 sekonda. Nuk ka rëndësi nëse aparati i dëgjimit është i ndezur ose i fikur para se të filloni të shtypni butonin. Nuk ka asnjë njoftim akustik apo me dritë në fund të 15 sekondave.
  2. Vendosni aparatin e dëgjimit në karikuesin e lidhur me burimin e energjisë dhe prisni derisa drita treguese të pulsojë në të gjelbër. Kjo mund të zgjasë deri në 30 sekonda. Aparati i dëgjimit tani është gati për përdorim.
- 
- 

## 17. Kushtet për përdorimin, transportin dhe ruajtjen

Kjo pajisje është projektuar në mënyrë të tillë që të funksionojë pa probleme apo kufizime nëse përdoret siç pritet, përveç rastit nëse përcaktohet ndryshe në këta udhëzues përdorimi.

Sigurohuni që t'i përdorni, t'i karikoni, t'i transportoni dhe t'i ruani aparatet e dëgjimit sipas kushteve të mëposhtme:

	Përdorimi	Karikimi	Transporti	Ruajtja
<b>Temperatura</b>				
Diapazoni maksimal	+5° deri në +40°C (41° deri në 104°F)	+5° deri në +40°C (41° deri në 104°F)	-20° deri në +60°C (-4° deri në 140°F)	-20° deri në +60°C (-4° deri në 140°F)
Diapazoni i rekomanduar	+5° deri në +40°C (41° deri në 104°F)	+7° deri në +32°C (45° deri në 90°F)	0° deri në +20°C (32° deri në 68°F)	0° deri në +20°C (32° deri në 68°F)
<b>Lagështia</b>				
Diapazoni maksimal	0% deri në 85% (jokondensuese)	0% deri në 85% (jokondensuese)	0% deri në 70%	0% deri në 70%
Diapazoni i rekomanduar	0% deri në 60% (jokondensuese)	0% deri në 60% (jokondensuese)	0% deri në 60%	0% deri në 60%
<b>Trysnia atmosferike</b>	500 hPa deri në 1060 hPa	500 hPa deri në 1060 hPa	500 hPa deri në 1060 hPa	500 hPa deri në 1060 hPa



Sigurohuni që t'i karikoni aparatet e dëgjimit rregullisht gjatë ruajtjes afatgjatë.

Këto aparate dëgjimi janë klasifikuar si IP68. Kjo do të thotë që ato janë rezistente ndaj ujit dhe pluhurit dhe janë projektuar për të përballuar situatat e jetës së përditshme. Ato mund të mbahen nën shi, por nuk duhet të zhyten plotësisht në ujë ose të përdoren kur bëni dush, kur notoni ose në aktivitete të tjera në ujë. Këto aparate dëgjimi nuk duhet të ekspozohen asnjëherë ndaj ujit me klor, me sapun, ujit të kripur ose lëngjeve të tjera me përmbajtje kimike.

Nëse pajisja ka qenë objekt i kushteve të ruajtjes dhe transportit të ndryshme nga kushtet e rekomanduara të përdorimit, prisni 15 minuta para se ta ndizni pajisjen.





## 18. Kujdesi dhe mirëmbajtja

---

### **Mbrojtja e aparateve të dëgjimit**

Jetëgjatësia e pritshme e shërbimit:

Aparatet e dëgjimit dhe karikuesi i përputhshëm kanë jetëgjatësi të pritshme shërbimi prej pesë vjetësh. Pajisjet pritet të mbeten të sigurta për përdorim për këtë kohëzgjatje.

Periudha e shërbimit komercial:

Kujdesi rutinë dhe rigoroz për aparatet e dëgjimit dhe karikuesin tuaj do të ndikojë në performancën e shkëlqyer për kohëzgjatjen e pritshme të jetëgjatësisë së shërbimit të pajisjeve tuaja.

Sonova AG do të sigurojë një periudhë shërbimi riparimi për minimumi pesë vite pasi aparati përkatës i dëgjimit, karikuesi dhe elementet thelbësore të tij të jenë hequr nga portofoli i produkteve.








Para se të përdorni spraj flokësh ose të aplikoni artikuj kozmetikë, duhet ta hiqni aparatën tuaj të dëgjimit nga veshi, sepse këto produkte mund ta dëmtojnë atë.

- Aparatet e dëgjimit janë rezistentë ndaj ujit dhe pluhurave në kushtet e mëposhtme:
  - Pas ekspozimit ndaj ujit ose pluhurave, aparati i dëgjimit pastrohet dhe thahet.
  - Aparati i dëgjimit përdoret dhe mirëmbahet siç përshkruhet në këtë udhëzues përdorimi.

 Sigurohuni gjithmonë që aparatet e dëgjimit dhe karikuesi të jenë të thatë dhe të pastër para karikimit.





## Çdo ditë

### **Aparati i dëgjimit:**

Kontrolloni gominën për dyllë veshi dhe depozitën e lagështisë dhe pastroni sipërfaqet me një leckë pa fije. Mos përdorni asnjëherë agjentë pastrimi si p.sh. detergjente shtëpiake, sapun etj. për pastrimin e aparatit të dëgjimit. Nuk rekomandohet shpëlarja me ujë. Nëse keni nevojë ta pastroni aparatin e dëgjimit intensivisht, pyesni audiologun tuaj për këshilla dhe informacione për filtrat ose kapsulat e tharjes.

### **Karikuesi:**

Sigurohuni që foletë e karikuesit të jenë të pastra. Mos përdorni asnjëherë agjentë pastrimi, si p.sh. detergjente shtëpiake, sapun etj. për pastrimin e karikuesit.





## Çdo javë

### Aparati i dëgjimit:

Pastroni gominën me një leckë të butë dhe të lagur ose me një leckë të veçantë pastrimi për aparatet e dëgjimit. Për udhëzime më të thelluara për mirëmbajtjen ose për më shumë se pastrimi bazë, këshillohuni me audiologun tuaj. Pastroni kontaktet e karikimit në aparatin e dëgjimit me një leckë të butë dhe të lagur.

### Karikuesi:

Hiqni pluhurat ose papastërtitë nga foletë e karikuesit.



Sigurohuni gjithmonë që karikuesi të shkëputet nga rrjeti elektrik para se ta pastroni.





## 19. Ndërrimi i mbrojtëses për dyllin e veshit

Aparati juaj i dëgjimit është i pajisur me një mbrojtëse për dyllin e veshit për ta mbrojtur altoparlantin nga dëmtimi prej dyllit të veshit.




Kontrolloni rregullisht mbrojtësen për dyllin e veshit dhe ndërrojeni nëse duket e papastër ose nëse volumi i aparatit të dëgjimit ose cilësia e zërit është reduktuar. Mbrojtësja për dyllin e veshit duhet të zëvendësohet çdo katër deri në tetë javë në një altoparlant të zakonshëm.



## Altoparlanti me gominë




### Heqja e gominës nga altoparlanti

1. Hiqni gominën nga altoparlanti duke e mbajtur altoparlantin në njërën dorë dhe gominën në tjetrën.
2. Tërhiqeni lehtë gominën për ta hequr.
3. Pastroni altoparlantin me një leckë pa fije.






## Ndërrimi i mbrojtëses për dyllin e veshit me diskun CeruShield™

1. Rrotulloni lehtë diskun CeruShield në drejtimin e treguar nga shigjetat derisa të shfaqet një hapësirë e lirë nën ikonën e koshit.
2. Për të hequr një mbrojtëse të përdorur për dyllin e veshit futni me kujdes altoparlantin në hapësirën e lirë (nën ikonën e koshit) derisa të të lëshojë një tingull kërcitës. Pas kërcitjes do të shihni mbrojtësen e përdorur për dyllin e veshit në hapësirën poshtë ikonës së koshit.
3. Për të futur një mbrojtëse të re për dyllin e veshit futni me kujdes altoparlantin në hapësirën ku duket mbrojtësja e re për dyllin e veshit (përballë ikonës së koshit) derisa të lëshojë një tingull kërcitës. Pas kërcitjes do të shikoni që hapësira më poshtë është bosh dhe mbrojtësja e re për dyllin e veshit është tani brenda altoparlantit.



## Vendosja e gominës tek altoparlanti

1. Mbani altoparlantin në njërën dorë dhe gominën në tjetrën.
2. Rrëshqitni gominën mbi vendin e daljes së zërit të altoparlantit.
3. Altoparlanti dhe gomina duhet të përputhen në mënyrë të përsosur së bashku.





## 20. Shërbimi dhe garancia

---

### **Garancia lokale**

Pyesni audiologun ku i keni blerë aparatet e dëgjimit dhe karikuesit për kushtet e garancisë lokale.

### **Garancia ndërkombëtare**

Sonova AG ofron një vit garanci të kufizuar ndërkombëtare, e vlefshme nga data e blerjes. Kjo garanci e kufizuar mbulon defektet e prodhimit dhe të materialeve përkatësisht në aparatin e dëgjimit dhe karikuesit, por jo aksesorët si tubat, kufjet ose altoparlantin e jashtëm. Garancia hyn në fuqi vetëm nëse tregohet një dëshmi e blerjes.

Garancia ndërkombëtare nuk prek asnjë të drejtë ligjore që mund të keni sipas legjislacionit kombëtar në fuqi që rregullon shitjen e mallrave të konsumit.







## Kufizimi i garancisë

Kjo garanci nuk mbulon dëmet nga administrimi ose kujdesi i papërshtatshëm, ekspozimi ndaj kimikateve ose trysnia e panevojshme. Dëmet e shkaktuara nga palë të treta ose qendra shërbimi të paautorizuara e bëjnë garancinë të pavlefshme. Kjo garanci nuk përfshin asnjë shërbim të kryer nga një audiolog në zyrën e tij.

Numrat e serisë

Aparati i dëgjimit i anës së majtë: \_\_\_\_\_

Aparati i dëgjimit i anës së djathtë: \_\_\_\_\_

Karikuesi: \_\_\_\_\_

Data e blerjes: \_\_\_\_\_

Audiologu i autorizuar (vula/nënshkrimi):

\_\_\_\_\_

## 21. Informacioni i pajtueshmërisë

### Deklarata e konformitetit për aparatet e dëgjimit

Sonova AG deklaron nëpërmjet këtij dokumenti se ky produkt përmbush kërkesat e Rregullores për pajisjet mjekësore MDR2017/745 dhe është në përputhje me Direktivën për radiopajisjet 2014/53/BE.

Teksti i plotë i Deklaratës së konformitetit të BE-së mund të merret nga prodhuesi nëpërmjet adresës së mëposhtme të internetit:  
[www.sonova.com/en/certificates](http://www.sonova.com/en/certificates).



Australi/Zelandë e Re:

Tregon pajtimin e një pajisjeje me përcaktimet rregullatore të Administratës së Radiospektrit (RSM) dhe të Autoritetit të Medias dhe Komunikimit të Australisë (ACMA) për shitje të ligjshme në Zelandën e Re dhe në Australi. Etiketa e pajtueshmërisë R-NZ është për radioproduktet e çarkulluara në tregun e Zelandës së Re sipas nivelit A1 të konformitetit.

**R-NZ**

Aparati i dëgjimit i përshkruar në këtë manual përdorimi është i certifikuar si:  
Sistem standard dëgjimi

SHBA - FCC ID: Kanada - IC:

AQ sound FS S

KWC-SLR

2262A-SLR

### Shënim 1

Kjo pajisje pajtohet me pjesën 15 të rregullave të FCC dhe me RSS-210 të Industry Canada. Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

- 1) kjo pajisje nuk shkakton interferencë të dëmshme, dhe
- 2) kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë funksionim të padëshiruar.



## Njoftimi 2

Ndryshimet ose modifikimet të bëra në këtë pajisje që nuk janë miratuar shprehimisht nga Sonova AG mund ta bëjnë të pavlefshëm autorizimin e FCC për përdorimin e kësaj pajisjeje.

## Njoftimi 3



Kjo pajisje është testuar dhe ka rezultuar në pajtim me kufijtë për pajisje dixhitale të klasit B, në përputhje me pjesën 15 të rregullave të FCC dhe ICES-003 të Industry Canada. Këta kufij janë krijuar për të ofruar mbrojtje të arsyeshme kundrejt interferencave të dëmshme në instalime në ambiente banimi. Kjo pajisje krijon, përdor dhe mund të rrezatojë energji radiofrekuence dhe, nëse nuk instalohet e përdoret në përputhje me udhëzimet, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme në radiokomunikime. Por nuk ka garanci se nuk do të ndodhë interferencë në instalime të caktuara. Nëse pajisja shkakton interferencë të dëmshme në marrjen e radios apo të televizorit, diçka që mund të përcaktohet duke e fikur dhe rindezur pajisjen, përdoruesit i sugjerohet të provojë ta zgjidhë interferencën me një a më shumë prej masave të mëposhtme:

- Riorientoni ose ndryshoni vendin e antenës marrëse
- Rritni distancën midis pajisjes dhe marrësit
- Lidhni pajisjen me një prizë të një qarku tjetër nga ai ku është lidhur marrësi
- Konsultohuni për ndihmë me shitësin apo një teknik radioje/televizori me përvojë

### Karikuesi

Mbani distancë ndarjeje së paku 20 cm midis karikuesit dhe trupit të njeriut gjatë funksionimit.





### **Informacioni i radiolidhjes së aparatit të dëgjimit me valë**

Lloji i antenës	Antena lineare me dy pole
Frekuenca e funksionimit	2,4 GHz - 2,48 GHz
Modulimi	GFSK, Pi/4 DQPSK, GMSK
Fuqia e rrezatuar	<2,5 mW


### **Bluetooth®**

Rrezja	~1 m
Bluetooth	4.2 Dual-Mode
Profillet e mbështetura	HFP (profili i përdorimit pa duar), A2DP



### **Pajtimi me standardet e emetimit dhe të imunitetit**

Standardet e emetimit	EN 60601-1-2
	IEC 60601-1-2
	EN 55011
	CISPR11
	CISPR32
	CISPR25
	EN 55025
	CISPR25:2016





Standardet e imunitetit	EN 60601-1-2
	IEC 60601-1-2
	EN 61000-4-2
	IEC 61000-4-2
	EN IEC 61000-4-3
	IEC 61000-4-3
	EN 61000-4-4
	IEC 61000-4-4
	EN 61000-4-5
	IEC 61000-4-5
	EN 61000-4-6
	IEC 61000-4-6
	EN 61000-4-8
	IEC 61000-4-8
	EN 61000-4-11
	IEC 61000-4-11
	IEC 60601-1
	ISO 7637-2



**Testi i emetimeve****Përputhshmëria****Udhëzimet për mjedisin elektromagnetik**Emetimet RF  
CISPR 11Grupi 2  
Klasa B

Pajisja mjekësore përdor energji RF vetëm për funksionin e saj të brendshëm. Për këtë arsye, emetimet e saj RF janë shumë të ulëta dhe nuk ka të ngjarë të shkaktojnë ndonjë interferencë në pajisjet elektronike në afërsi

Emetimet  
harmonike

Në përputhje

Luhatjet e  
tensionit/  
emetimet e  
dridhjeve

Në përputhje

## 22. Informacion dhe shpjegimi i simboleve



Me simbolin CE, Sonova AG konfirmon se ky produkt, duke përfshirë aksesorët, përmbush kërkesat e Rregullores për pajisjet mjekësore (BE) 2017/745 si dhe të Direktivës për radiopajisjet 2014/53/BE. Numrat pas simbolit CE përkojnë me kodin e institucioneve të certifikuara që janë konsultuar sipas direktivës dhe rregullores së sipërpërmendur.



Ky simbol tregon se produktet e përshkruara në këto udhëzime përdorimi janë në pajtim me kërkesat për pjesë të aplikuara të tipit B të standardit EN 60601-1. Sipërfaqja e aparatit të dëgjimit përcaktohet si pjesë e aplikuar e tipit B.



Tregon prodhuesin e pajisjes mjekësore, siç përcaktohet në Rregulloren për pajisjet mjekësore (BE) 2017/745.



Tregon përfaqësuesin e autorizuar në Komunitetin Evropian. Përfaqësuesi në Komunitetin Evropian është po ashtu importuesi në Bashkimin Evropian.



Ky simbol tregon se është e rëndësishme që përdoruesi të lexojë dhe të marrë parasysh informacionet përkatëse në këta udhëzues përdorimi.



Ky simbol tregon se është e rëndësishme që përdoruesi t'u kushtojë vëmendje deklaratave përkatëse paralajmëruese në këtë udhëzues përdorimi.



Informacion i rëndësishëm për trajtimin dhe sigurinë e produktit.



Simboli i të drejtave të autorit



Ky simbol tregon se interferenca elektromagnetike nga pajisja është nën kufijtë e miratuar nga Komisioni Federal i Komunikimeve në Shtetet e Bashkuara.



Tregon pajtimin e një pajisjeje me përcaktimet rregullatore të Administratës së Radiospektrit (RSM) dhe të Autoritetit të Media dhe Komunikimit të Australisë (ACMA) për shitje të ligjshme në Zelandën e Re dhe në Australi.



**Bluetooth** Fjala e markës dhe logot e Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i markave të tilla nga Sonova kryhet nën licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë janë sipas zotëruesve të tyre përkatës.



Marka japoneze për pajisjen radio të certifikuar



Ky simbol tregon se kjo është një pajisje me recetë. **KUJDES:** Ligji federal amerikan e kufizon këtë pajisje për shitje nga ose me urdhër të një mjeku ose të një audiologu (vetëm për SHBA).



Tregon datën kur është prodhuar pajisja mjekësore





**SN**

Tregon numrin e serisë të prodhuesit që të mund të identifikohet pajisja specifike mjekësore.

**REF**

Tregon numrin e katalogut të prodhuesit që të mund të identifikohet pajisja mjekësore

**MD**

Tregon se pajisja është një pajisje mjekësore.



Ky simbol tregon se është e rëndësishme që përdoruesi të lexojë dhe të marrë parasysh informacionin përkatës në këtë udhëzues përdorimi.



Temperatura gjatë transportit dhe ruajtjes



Lagështia gjatë transportit dhe ruajtjes



Trysnia atmosferike gjatë transportit dhe ruajtjes



Mbajeni të thatë gjatë transportit.



Simboli me koshin e shënuar me kryq përdoret për t'ju bërë me dije se kjo pajisje, si dhe karikuesit, nuk duhet të hidhen si mbeturina të zakonshme shtëpiake. Pajisjet e vjetra apo të papërdorura hidhini në pikat e posaçme të hedhjes së mbetjeve elektronike, ose dorëzoheni pajisjen tuaj tek audiologu për ta hedhur. Hedhja e duhur mbron mjedisin dhe shëndetin.

## IP68

Vlerësimi IP = Vlerësimi i mbrojtjes nga uji dhe pluhuri. Vlerësimi IP68 tregon se aparati i dëgjimit është rezistent ndaj ujit dhe pluhurit. Ai ka mbijetuar në një zhytje të vazhdueshme në 1 metër në ujë të ëmbël për 60 minuta dhe 8 orë në një dhomë me pluhur sipas standardit IEC60529



Ky simbol tregon se është e rëndësishme që përdoruesi t'u kushtojë vëmendje njoftimeve përkatëse paralajmëruese në lidhje me bateritë në këto udhëzues përdorimi.

## Simbolet e zbatueshme vetëm për ushqyesin në Evropë



Ushqyesi me izolim të dyfishtë



Pajisja është projektuar vetëm për përdorim në ambiente të brendshme.



Transformator izolues për sigurinë, i mbrojtur nga qarku i shkurtër

## 23. Udhëzuesi i zgjidhjes së problemeve

Shkaku	Masa e mundshme
<b>Problemi: Aparati i dëgjimit nuk funksionon</b>	
Altoparlanti/gomina është bllokuar	Pastroni gominën/hapësirën e altoparlantit
Aparati i dëgjimit është i fikur	Shtypni butonin me shumë funksione
Bateria ka mbaruar	Karikoni aparatin e dëgjimit
<b>Problemi: Aparati i dëgjimit fërshëllen</b>	
Aparati i dëgjimit nuk është vendosur siç duhet në vesh	Vendosni aparatin e dëgjimit në mënyrën e duhur (shikoni kapitullin 6)
Ka cerumen në kanalën e veshit	Kontakttoni me mjekun për veshin, hundën dhe fytyrën / mjekun e përgjithshëm ose me audiologun
<b>Problemi: Aparati i dëgjimit ka shumë zë</b>	
Volumi shumë i lartë	Ulni volumin nëse kontrolli i volumit është i disponueshëm (shikoni kapitullin 8)



## Shkaku

## Masa e mundshme

**Problemi: Aparati i dëgjimit nuk ka zë të mjaftueshëm ose zëri shtrembërohet**

Volumi shumë i ulët

Rritni volumin nëse kontrolli i volumit është i disponueshëm (shikoni kapitullin 8)

Ka rënë bateria

Karikoni aparatin e dëgjimit

Altoparlanti/kufja është bllokuar

Pastroni kufjen/hapësirën e altoparlantit

Dëgjimi ka ndryshuar

Kontaktoni me audiologun tuaj



**Problemi: Aparati i dëgjimit luan dy tinguj bip**



Treguesi për nivelin e ulët të baterisë

Karikoni aparatin e dëgjimit

**Problemi: Aparati i dëgjimit nuk ndizet**

Bateria është shkarkuar / ka mbaruar

Karikoni aparatin e dëgjimit

Butoni është çaktivizuar pa dashje duke shtypur butonin më gjatë se 15 sekonda

Kryeni hapin 2 të procesit të rindezjes (Kapitulli 16)



## Shkaku

## Masa e mundshme

**Problemi:** Drita treguese në aparatin e dëgjimit nuk ndizet kur aparati i dëgjimit vendoset në foletë e karikimit

Aparati i dëgjimit nuk është futur siç duhet në karikues

Futni aparatin e dëgjimit siç duhet në karikues

Karikuesi nuk është futur në prizë

Lidhni karikuesin me një burim të jashtëm energjie

Bateria është shkarkuar / ka mbaruar

Prisni për tre orë pas vendosjes së aparatit të dëgjimit në karikues, pavarësisht nga sjellja e dritës LED

**Problemi:** Drita treguese në aparatin e dëgjimit është e kuqe e qëndrueshme ndërkohë që aparati i dëgjimit është në karikues

Kontaktet e karikimit janë të papastra

Pastroni kontaktet e aparatit të dëgjimit dhe të karikuesit

Aparati i dëgjimit është jashtë diapazonit të temperaturave të përdorimit

Ngroheni aparatin e dëgjimit. Diapazoni i temperaturës së përdorimit është +5° deri +40° celsius (+41° deri +104° fahrenheit)

Bateria ka problem

Kontaktoni me audiologun tuaj

## Shkaku

## Masa e mundshme

**Problemi:** Drita treguese në aparatin e dëgjimit fiket kur aparati i dëgjimit hiqet nga karikuesi

Veçoria “Auto On” (Ndezja automatike) është çaktivizuar

Ndizni aparatin e dëgjimit

**Problemi:** Drita treguese në aparatin e dëgjimit qëndron me ngjyrë të gjelbër të qëndrueshme pas heqjes nga karikuesi

Drita treguese në aparatin e dëgjimit ishte e kuqe kur aparati i dëgjimit u vendos në karikues

Rindizni aparatin e dëgjimit (Kapitulli 16)

**Problemi:** Bateria nuk zgjat për gjithë ditën

Jetëgjatësi e shkurtuar e baterisë

Kontaktoni me audiologun tuaj. Mund të nevojitet një zëvendësim i baterisë

**Problemi:** Funkzioni i telefonatës nuk punon

Aparati i dëgjimit është në modalitet fluturimi

Fikeni dhe rindizeni aparatin e dëgjimit

Aparati i dëgjimit nuk është i çiftuar me telefonin

Çiftoni aparatin e dëgjimit me telefonin (Kapitulli 13)



## Shkaku

## Masa e mundshme


**Problemi: Karikimi nuk fillon kur karikuesi është i lidhur me burimin e energjisë**

Aparati i dëgjimit nuk është futur siç duhet në karikues

Futni aparatin e dëgjimit siç duhet në karikues

Karikuesi nuk është i lidhur siç duhet me burimin e energjisë

Rregulloni karikuesin dhe kontrolloni lidhjen me burimin e energjisë

 Nëse problemi vazhdon, kontaktoni me audiologun tuaj për ndihmë.





## 24. Informacione të rëndësishme për sigurinë

---

Lexoni informacionet përkatëse të sigurisë dhe informacionet për kufizimet e përdorimit para se të përdorni aparatit tuaj të dëgjimit.

### **Përdorimi i synuar**

Aparatet e dëgjimit synohen të përdoren për të amplifikuar dhe përçarur zërin drejt veshëve, duke kompensuar kështu problemet e dëgjimit.

Veçoria e tinitusit është planifikuar për përdorim nga personat që kanë tinitus dhe që dëshirojnë amplifikimin e zërit. Ajo siguron një stimulim plotësues të zhurmës që mund të ndihmojë për shpërqendrimin e vëmendjes së përdoruesit nga tinitusi.

Karikuesit janë planifikuar për të karikuar baterinë e aparatit të dëgjimit të rikarikueshëm.

### **Popullata e synuar e pacientëve:**

Aparatet e dëgjimit: Kjo pajisje është planifikuar për pacientët me humbje të njëanshme dhe të dyanshme, të lehtë deri në të rëndë të dëgjimit nga mosha 8 vjeç. Veçoria e softuerit të tinitusit është planifikuar për pacientët me tinitus kronik nga 18 vjeç.







Karikuesi: Popullata e synuar e pacientëve janë përdoruesit e aparateve të përputhshëm të dëgjimit.

### **Përdoruesi i synuar:**

Aparatet e dëgjimit: Planifikuar për personat me humbje të dëgjimit që përdorin një aparat dëgjimi dhe për personat me humbje të dëgjimit dhe për kujdestarët e tyre. Audiologu është përgjegjës për rregullimin e aparatit të dëgjimit.

Karikuesi: I planifikuar për personat me humbje të dëgjimit që përdorin aparatin e përputhshëm të rikarikueshëm të dëgjimit dhe për kujdestarët e tyre, ose për audiologun.



### **Indikacionet:**

**Indikacionet e përgjithshme klinike për përdorimin e aparateve të dëgjimit dhe veçorisë së tinitusit janë:**

- Prania e humbjes së dëgjimit
- Humbja e dëgjimit në një ose të dyja anët
- Humbje dëgjimi e përçueshmërisë, sensore-neurale ose e përzier
- Humbje e lehtë deri në e thellë e dëgjimit
- Prania e tinitusit kronik (e vlefshme vetëm për pajisjet që ofrojnë veçorinë e tinitusit)





## Kontraindikacionet

Kundërindikacionet e përgjithshme klinike për përdorimin e aparateve të dëgjimit dhe softuerit të tinitusit janë:

- Humbja e dëgjimit nuk është në rrezën e vendosjes së aparatit të dëgjimit (d.m.th. mbulimi, përfshirja e të gjithë gamës së frekuencave)
- Tinitus akut
- Deformimi i veshit (d.m.th. kanali i veshit i mbyllur; mungesa e aurikulës)
- Humbja neurale e dëgjimit (patologjitë retrokokleare si p.sh. mungesa/mosfunksionimi i nervit të dëgjimit)

Karikuesi: Kini parasysh se kundërindikacionet nuk lidhen me karikuesin, por me aparatet e përputhshme të dëgjimit.

Kriteri kryesor për rekomandimin e një pacienti për një opinion mjekësor ose nga një specialist tjetër dhe/ose trajtimin janë si më poshtë:

- Deformim i dukshëm nga lindja ose traumatike e veshit;
- Histori e rrjedhjeve aktive nga veshi brenda 90 ditëve të kaluara;



- Histori e humbjes së papritur ose me progres të shpejtë të dëgjimit në një ose në të dy veshët brenda 90 ditëve të kaluara;
- Marramendje akute ose kronike;
- Diferencë audiometrike ajrore e barabartë ose më e madhe se 15 dB në 500 Hz, 1000 Hz dhe 2000 Hz;
- Dëshmi e dukshme e grumbullimit të konsiderueshëm të dyllit të veshit ose të një trupi të huaj në kanalën e veshit;
- Dhimbje ose shqetësim në vesh;
- Pamje jonormale e daullës së veshit dhe kanalit të veshit si p.sh.:
  - Inflamacion i kanalit të jashtëm të dëgjimit;
  - Daulja e veshit e shpuar;
  - Anomali të tjera që profesionisti i kujdesit shëndetësor beson se janë shqetësuese në aspektin mjekësor





Audiologu mund të vendosë që nuk nevojitet një rekomandim ose si të jetë më e përshtatshme për pacientin në situatat e mëposhtme:

- Kur ka prova të mjaftueshme se gjendja është ekzaminuar plotësisht nga një specialist mjekësor dhe është dhënë çdo trajtim i mundshëm;
- Gjendja nuk është përkeqësuar apo nuk ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme që nga ekzaminimi dhe/ose trajtimi i mëparshëm.

Nëse pacienti ka shprehur vendimin e tij kompetent dhe të mirinformuar që nuk do të pranojë këshilla për të kërkuar një opinion mjekësor, lejohet që të vazhdohet me rekomandimin e sistemeve të përshtatshme të aparateve të dëgjimit duke pasur parasysh konsideratat e mëposhtme:

- Rekomandimi nuk do të ketë efekte negative në shëndetin e pacientit ose mirëqenien e përgjithshme të tij;
- Të dhënat konfirmojnë që janë marrë parasysh të gjitha konsideratat e nevojshme për interesat më të mira të pacientit.





Nëse kërkohet në aspektin ligjor, pacienti ka nënshkruar një deklaratë për mohimin e përgjegjësisë për të konfirmuar që nuk është pranuar këshilla për rekomandim dhe që ky është një vendim i mirinformuar.

### **Përfitimi klinik**

Aparati i dëgjimit: Përmirësimi i të kuptuarit të fjalëve.

Veçoria e tinitusit: veçoria e tinitusit siguron një stimulim plotësues të zhurmës që mund të ndihmojë për shpërqendrimin e vëmendjes së përdoruesit nga tinitusi.

Karikuesi: Vetë karikuesi nuk ofron një përfitim të drejtpërdrejtë klinik. Një përfitim i tërthortë klinik sigurohet duke bërë të mundur që pajisja mëmë (aparartet e rikarikueshme të dëgjimit) të arrijë qëllimin e saj të synuar.

### **Efektet anësore**

Efektet anësore fiziologjike të aparateve të dëgjimit si tinitusi, marramendja, grumbullimi i dyllit, presioni i lartë, djersitja ose lagështia, flluskat, kruajtjet dhe/ose skuqjet, ndjesia e mbushjes dhe bllokimit dhe pasojat e tyre si dhimbja e kokës dhe/ose e veshit





mund të zgjidhen nga audiologu juaj. Aparatet tradicionale të dëgjimit kanë mundësi ta ekspozojnë pacientin ndaj niveleve të larta të ekspozimit ndaj tingujve, gjë që mund të shkaktojë lëvizje të pragut të diapazonit të frekuencave nën efektin e traumës akustike.

Karikuesi: Kini parasysh se efektet anësore nuk lidhen me karikuesin, por me aparatet e përputhshme të dëgjimit.

Aparati i dëgjimit është i përshtatshëm për ambientet e kujdesit shëndetësor në shtëpi dhe për shkak të mundësisë së lëvizjes së tyre, mund të përdoret në ambiente të kujdesit shëndetësor profesional si zyrat e mjekëve, zyra dentare etj.

Aparati i dëgjimit nuk e rikthen dëgjimin normal dhe nuk parandalon apo përmirëson problemet e dëgjimit që vijnë nga shkaqe organike. Përdorimi jo i shpeshtë i aparatit të dëgjimit nuk e lejon përdoruesin të përfitojë plotësisht prej tij. Përdorimi i aparatit të dëgjimit është vetëm një pjesë e ofrimit të dëgjimit dhe mund të ketë nevojë të plotësohet nga trajnime audimore dhe udhëzime për leximin e buzëve.





Reagimi, cilësia e dobët e tingujve, tingujt shumë të lartë ose shumë të ulët, përshtatja jo e duhur ose problemet gjatë përtypjes ose gëlltitjes mund të zgjidhen ose të përmirësohen gjatë procesit të rregullimit në procedurën e vendosjes së aparatit nga audiologu.

Çdo incident serioz që ka ndodhur në lidhje me pajisjen duhet të raportohet te përfaqësuesi i prodhuesit dhe tek autoriteti përkatës në shtetin e rezidencës. Incident serioz përshkruhet si çdo incident që shkakton, mund të ketë shkakuar ose mund të shkaktojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një nga sa më poshtë:

- vdekjen e pacientit, përdoruesit ose një personi tjetër
- përkeqësimin serioz të përkohshëm ose të përhershëm të gjendjes shëndetësore të një pacienti, përdoruesi ose personi tjetër
- një kërcënim serioz për shëndetin publik

Për të raportuar një veprim ose situatë të papritur, kontaktoni me prodhuesin ose një përfaqësues.



## Paralajmërimet e rrezikut



**PARALAJMËRIM:** Aparatet e dëgjimit përdorin një bateri me qeliza jone litiumi. Këto bateri janë të rrezikshme dhe mund të shkaktojnë lëndime të rënda ose fatale në 2 orë ose më pak nëse gëlltiten ose vendosen brenda çdo pjese të trupit, pavarësisht nëse bateria është e përdorur apo e re! Mbajeni larg fëmijëve, personave me aftësi të kufizuar intelektuale ose kafshëve shtëpiake. Nëse dyshoni se një bateri është gëlltitur ose vendosur brenda ndonjë pjese të trupit, konsultohuni menjëherë me mjekun pa asnjë vonesë!



Aparatet e rikarikueshme të dëgjimit përmbajnë bateri me jone litiumi dhe karikuesi përmban një bateri me polimere litiumi që mund të mbahet në aeroplanë si bagazh dore. Aparatet e dëgjimit nuk mund të vendosen në bagazhin e regjistruar por vetëm në bagazhin e dorës.





Aparatet tuaja të dëgjimit funksionojnë në diapazonin e frekuencës 2,4 GHz - 2,48 GHz. Kur jeni në fluturim, kontrolloni nëse operatori i fluturimit kërkon që pajisjet të kalohen në modalitetin e fluturimit; shikoni kapitullin 15.












- ⚠ Aparatet e dëgjimit (posaçërisht të programuar për çdo humbje dëgjimi) duhet të përdoren vetëm nga personi i synuar. Aparatet nuk duhet të përdoren nga askush tjetër, pasi përndryshe mund t'u dëmtohet dëgjimi.
- ⚠ Nuk lejohen ndryshimet apo modifikimet e aparatit të dëgjimit pa miratimin e shprehur qartë nga Sonova AG. Ndryshime të tilla mund t'ju dëmtojnë veshët ose aparatin e dëgjimit.
- ⚠ Mos i përdorni aparatet e dëgjimit dhe aksesoret e karikimit në zona shpërthimi (miniera ose zona industriale me rrezik shpërthimesh, ambiente të pasura me oksigjen ose zona ku përdoren anestetikë të djegshëm). Pajisja nuk është e certifikuar nga ATEX.
- ⚠ Nëse keni dhimbje në vesh ose prapa veshit, nëse është irrituar ose ka irritim të lëkurës dhe akumulim të shpejtë të dyllit të veshit, kontaktoni me mjekun ose me audiologun.
- ⚠ Në raste shumë të rralla, gomina mund të mbetet në kanalën e veshit kur ta hiqni tubin e dëgjimit nga veshi. Në rastet e rralla kur gomina mund të ngecë në kanalën e veshit, rekomandohet të kontaktoni me mjekun për heqjen e saj në mënyrë të sigurt. Për të parandaluar









shtytjen e gominës drejt daulles së veshit, mos u përpiqni asnjëherë ta futni përsëri altoparlantin në kanalën e veshit.

- 
- Programet e dëgjimit në modalitetin e mikrofonit të drejtuar pakësojnë zhurmat e sfondit. Kini parasysh se sinjalet apo zhurmat paralajmëruese që vijnë nga pas, p.sh. automjetet, mbyten pjesërisht ose tërësisht.
- 
- Ky aparat dëgjimi nuk është për foshnja nën moshën 36 muajshe. Përdorimi i kësaj pajisjeje nga fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale duhet të kryhet nën mbikëqyrje të vazhduar, për të garantuar sigurinë e tyre. Aparati i dëgjimit është pajisje e vogël dhe përmban pjesë të vogla. Mos ua lini pa mbikëqyrje këtë aparat dëgjimi fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara intelektuale. Në rast gëlltitjeje, konsultohuni menjëherë me mjekun apo spitalin, pasi aparati i dëgjimit apo pjesët e tij mund të shkaktojnë mbytje!
- 
- Sa më poshtë vlen vetëm për personat me pajisje të implantueshme aktive mjekësore (p.sh. stimulues kardiakë, defibrilatorë etj.)
- Mbajeni aparatën e dëgjimit me valë dhe karikuesin të paktën 15 cm (6 inç) larg implantit aktiv. Nëse
- 
- 



vëreni ndonjë interferencë, mos i përdorni aparatet e dëgjimit me valë dhe kontakti me prodhuesin e implantit aktiv. Kini parasysh se interferenca mund të shkaktohet dhe nga linjat elektrike, shkarkesat elektrostatike, detektorët e metaleve në aeroporte, etj.

- Mbajini magnetet (p.sh. mjetet për mbajtjen e baterisë, etj.) të paktën 15 cm (6 inç) larg nga implanti aktiv.
- ⚠ Pacientët me valvula të implantuara të shuntit magnetike dhe të programueshme nga jashtë (CSF) mund të kenë rrezikun për një ndryshim të padëshiruar në cilësimin e valvulës kur ekspozohen ndaj fushave të forta magnetike. Marrësi (altoparlanti) i aparateve të dëgjimit përmban magnetete statike. Mbani një distancë prej 2 inç (afërsisht 5 cm) ose më shumë midis magneteteve dhe vendit të valvulës së implantuar të shuntit.
- ⚠ Përdorimi i kësaj pajisjeje pranë apo përmbi pajisje të tjera duhet evituar, pasi mund të sjellë keqfunksionim. Nëse ju duhet ta përdorni në mënyrë të tillë, kjo pajisje dhe pajisjet e tjera duhet të mbikëqyren për të verifikuar nëse punojnë në rregull.

- 
- 
- ⚠ Përdorimi i aksesorëve, konvertuesve dhe kablllove të tjera nga ato të përcaktuara apo të dhëna nga prodhuesi i kësaj pajisjeje mund të shkaktojnë rritje të emetimeve elektromagnetike ose rënie të imunitetit elektromagnetik të pajisjes duke sjellë funksionim të papërshtatshëm.
- ⚠ Pajisjet portative të komunikimit me radiofrekuenca (duke përfshirë pajisjet periferike si p.sh. kabllot e antenave dhe antenat e jashtme) duhet të përdoren së paku 30 cm (12 inç) larg aparateve të dëgjimit, duke përfshirë kabllot e rekomanduara nga prodhuesi. Përndryshe mund të ketë rënie efikasiteti të pajisjes.
- ⚠ Për karikuesin, përdorni vetëm pajisje të certifikuar sipas IEC 60950-1 \*, IEC 62368-1 ose IEC 60601-1 me një vlerë nominale dalëse 5 VDC. Min. 500 mA.
- 
- 



\* Shënim: ky standard mund të mos jetë më i vlefshëm në vendin tuaj, referojuni IEC 62368-1









- ⚠ Aparatet e dëgjimit nuk duhet të përdoren me sistemet e mbrojtjes për dyllin e veshit / gominën kur përdoren nga klientë me daulle veshi të shpuar, kanal veshi të irrituar ose kavitate të tjera të ekspozuara të veshit të mesëm. Në raste të tilla, ne rekomandojmë përdorimin e një kufjeje të personalizuar. Në rastet e rralla kur ndonjë pjesë e këtij produkti mund të ngecë në kanal in e veshit, rekomandohet të vizitoheni nga një mjek specialist për heqjen e saj në mënyrë të sigurt.
- ⚠ Mos i prekni kontaktet e karikuesit kur është i ndezur
- ⚠ Shmangni goditjet e forta fizike në vesh kur mbani një aparat dëgjimi me një kufje të personalizuar. Qëndrueshmëria e kufjeve të personalizuar është planifikuar për një përdorim normal. Një goditje e fortë fizike në vesh (p.sh. në sporte) mund të shkaktojë thyerjen e kufjes së personalizuar. Kjo mund të shkaktojë shpimin e kanalit të veshit ose të daullës së veshit.
- ⚠ Pas një goditjeje ose presioni mekanik ndaj kufjes së personalizuar, sigurohuni që ajo të jetë e padëmtuar para se ta vendosni në vesh.



- 
- 
- ⚠ Pjesa më e madhe e përdoruesve të aparateve të dëgjimit kanë një humbje të dëgjimit për të cilën nuk pritet një përkeqësim i dëgjimit nga përdorimi i rregullt i një aparati dëgjimi në situatat e përditshme. Vetëm një grup i vogël i përdoruesve të aparateve të dëgjimit me humbje të dëgjimit mund të jenë në rrezik për përkeqësim të dëgjimit në periudha të gjata përdorimi.
- ⚠ Mos e përdorni aparatën e dëgjimit ose karikuesin në zona ku ndalohet përdorimi i pajisjeve elektronike.
- ⚠ Aparatet e dëgjimit duhet të jenë të thatë përpara vendosjes në karikim. Përndryshe qëndrueshmëria e karikimit nuk garantohehet.
- ⚠ Përdorni vetëm karikuesit e miratuar siç përshkruhet në këtë udhëzues përdorimi për karikimin e aparateve të dëgjimit, në rast të kundërt pajisjet mund të dëmtohen.
- ⚠ Aparatet e dëgjimit përfshijnë bateri me jone litiumi me një vlerë nominale në vat-orë <20 Wh, të cilat janë testuar sipas UN 38.3 nga “Manuali i Kombeve të Bashkuara për testet dhe kriteret” dhe duhet të transportohen në përputhje me të gjitha rregullat dhe rregulloret për transportin e sigurt të baterive me jone litiumi.

- 
- 
- ⚠ Mos i hiqni kabllot e marrësit nga instrumentet e dëgjimit. Nëse kërkohet heqja ose ndërrimi, rekomandohet të kontaktoni me audiologun.
  - ⚠ Mos i mbuloni tërësisht kutitë e karikimit gjatë karikimit, p.sh. me një leckë, etj.
  - ⚠ Vetëm personeli i autorizuar lejohet ta hapë aksesoren e karikimit për shkak të rrezikut të mundshëm nga elektriciteti.
  - ⚠ Kabllot dhe kordonët e mbështjellë rreth qafës mund të shkaktojnë mbytje. Mos e lini pajisjen dhe komponentët e saj të pambikëqyrrur me fëmijët, individët me aftësi të kufizuara intelektuale ose kafshët shtëpiake.
- 
- 

## Siguria e produktit

- ① Këto aparate dëgjimi janë rezistent ndaj ujit, por jo hermetik. Aparatet janë krijuar për t'u bërë ballë aktiviteteve normale dhe ekspozimit aksidental të rastit ndaj kushteve ekstreme. Mos e zhytni kurrë aparatin e dëgjimit në ujë! Këto aparate dëgjimi nuk janë krijuar specifikisht për të qëndruar për periudha të gjata dhe rregullisht nën ujë, si p.sh. duke i mbajtur gjatë aktiviteteve si noti apo larja. Hiqeni gjithnjë aparatin e dëgjimit përpara këtyre aktiviteteve, pasi aparati përmban pjesë elektronike delikate.
- ① Mos i lani asnjëherë hyrjet e mikrofonit. Ky veprim mund të shkaktojë humbjen e karakteristikave të tyre speciale akustike.
- ① Mbrojeni aparatin e dëgjimit dhe aksesorët e karikimit nga nxehtësia dhe drita e diellit (mos i lini kurrë pranë një dritareje apo në makinë). Mos përdorni kurrë mikrovalë apo pajisje të tjera ngrohëse për tharjen e aparatit të dëgjimit ose aksesorëve të karikimit (për shkak të rrezikut të zjarrit ose shpërthimit). Pyesni audiologun tuaj për mënyrat e duhura të tharjes.





- ① Mos i vendosni aksesorët e karikimit pranë një sipërfaqeje gatimi me induksion. Strukturat përcjellëse brenda aksesorëve të karikimit mund të thithin energjinë e induksionit duke shkaktuar shkatërrimin termik.
- ① Gomina duhet të ndryshohet çdo tre muaj ose kur bëhet e ngurtë apo delikate. Kjo bëhet për të parandaluar shqitjen e gominës nga gryka e tubit gjatë futjes apo heqjes nga veshi.
- ① Mos e rrëzoni aparatin e dëgjimit apo aksesorët e karikimit! Rrëzimi në një sipërfaqe të fortë mund të dëmtojë aparatin e dëgjimit ose aksesorët e karikimit.
- ① Karikuesi dhe ushqyesi duhet të mbrohen nga goditjet. Nëse karikuesi ose ushqyesi dëmtohen nga një goditje, pajisjet nuk duhet të përdoren më.
- ① Nëse nuk e përdorni aparatin e dëgjimit për një kohë të gjatë, ruajeni në një kuti me një kapsulë tharjeje ose në një vend të ajrosur mirë. Kjo lejon që lagështia të avullojë nga aparati i dëgjimit dhe të parandalojë një ndikim të mundshëm në performancën e tij.





- ① Sigurohuni që ta thani gjithmonë plotësisht aparatën tuaj të dëgjimit pas përdorimit. Ruajeni aparatën e dëgjimit në një vend të sigurt, të thatë dhe të pastër.
- ① Ekzaminimet e posaçme mjekësore apo dentare, ku përfshihet rrezatimi i përshkruar më poshtë, mund të cenojnë funksionimin normal të aparateve të dëgjimit. Hiqni dhe mbajini jashtë sallës/zonës së ekzaminimit përpara se të kryeni:
- Ekzaminime mjekësore ose dentare me rreze rëntgen (si dhe skanime të tomografisë së kompjuterizuar).
  - Ekzaminime mjekësore me skanime MRI/NMRI, ku krijohen fusha magnetike.
- Aparatet e dëgjimit nuk kanë nevojë të hiqen kur kaloni në portat e sigurisë (p.sh. aeroporte etj.). Nëse përdoren rreze rëntgen në çfarëdo rasti, ato do të jenë në doza shumë të vogla dhe nuk ndikojnë në aparatet e dëgjimit.



## Vlera nominale e pajtueshmërisë me telefonat celularë

Disa përdorues të aparateve të dëgjimit kanë raportuar një tingull gumëzhime në aparatet e tyre gjatë përdorimit të telefonave celularë. Sipas standardit ANSI 63.19 (Metodat e matjes së përputhshmërisë midis pajisjeve të komunikimit me valë dhe instrumenteve të dëgjimit sipas standardit kombëtar amerikan), përputhshmëria e një aparati të caktuar dëgjimi dhe e një telefoni celular mund të parashikohet duke i shtuar vlerën nominale të imunitetit të aparatit të dëgjimit vlerës nominale për emetimet e telefonit celular. Shuma e vlerës nominale të aparatit të dëgjimit (p.sh.  $M_2/T_2=2$ ) dhe vlerës nominale të telefonit (p.sh.  $M_3/T_3=3$ ) është 5, dhe çdo kombinim që është i barabartë me 5 do të sigurojë "përdorim normal"; një shumë prej 6 ose më e madhe do të tregojë "performancë të shkëlqyer". Matjet e performancës së pajisjes, kategoritë dhe klasifikimet e sistemit bazohen mbi informacionin më të mirë të mundshëm, por nuk garantojnë dot që do të përmbushen kërkesat e të gjithë përdoruesve. Imuniteti i këtij aparati dëgjimi është të paktën  $M_2/T_2$ .



- ① Performanca e aparateve individuale të dëgjimit mund të ndryshojë me telefonat celularë individualë. Prandaj, provoni aparatin tuaj të dëgjimit me telefonin celular ose, nëse jeni duke blerë një telefon të ri, sigurohuni ta provoni me aparatin e dëgjimit para se ta blini. Për udhëzime shtesë, pyesni audiologun tuaj.





## Aparati për reduktimin e tinitusit

---

Aparati për reduktimin e tinitusit përdor zhurmë me brez të gjerë për të dhënë një qetësim të përkohshëm nga tinitusi.

### **Njoftim i rëndësishëm për përdoruesit e aparatit për reduktimin e tinitusit**

Aparati për reduktimin e tinitusit është një zhurmues me brez të gjerë. Ai bën të mundur terapinë me pasurim tingujsh që mund të përdoret si pjesë e një programi të personalizuar për menaxhimin e tinitusit (zhurmës në veshë), për të ofruar qetësim nga tinitusi.

Parimi bazë i pasurimit të tingujve është dhënia e stimulimit shtesë me zhurmë, çka mund të ndihmojë në shkëputjen e vëmendjes suaj nga tinitusi duke evituar kështu reagimet negative. Pasurimi i tingujve, së bashku me konsultat udhëzuese, është një qasje funksionale për menaxhimin e tinitusit.

Praktika e mirë shëndetësore kërkon që personi që raporton për tinitus të marrë një vlerësim mjekësor nga një audiolog i licencuar përpara se të përdorë një pajisje zhurmëkrijuese. Qëllimi i një vlerësimi të tillë është të sigurojë që sëmundjet e trajtueshme nga ana mjekësore, të cilat mund të shkaktojnë tinitusin, të identifikohen dhe të trajtohen përpara përdorimit të pajisjes zhurmëkrijuese.



Nëse ju shfaqen efekte anësore gjatë përdorimit të aparatit për reduktimin e tinitusit, si p.sh. dhimbje koke, të vjella, marramendje ose palpitatione kardiake, apo vëreni rënie të funksionit dëgjimor si p.sh. rënie të tolerancës ndaj zërit të lartë, përkeqësim të tinitusit, ose të folurit nuk është më aq i qartë, duhet ta ndërpritni përdorimin e pajisjes dhe të kërkonit kujdes mjekësor.

Sipas rregulloreve të OSHA (Administrata Amerikane e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, Departamenti i Punës), volumi i aparatit për reduktimin e tinitusit mund të vendoset në një nivel që mund të çojë në dëmtim të përhershëm të dëgjimit kur përdoret për një periudhë të zgjatur kohe. Nëse aparati për reduktimin e tinitusit është caktuar në nivel të tillë në aparatet tuaja të dëgjimit, audiologu do t'ju këshillojë për kohëzgjatjen maksimale gjatë ditës kur mund ta përdorni aparatin për reduktimin e tinitusit. Aparati për reduktimin e tinitusit nuk duhet të përdoret kurrë në nivele jokomode.




## Komentet tuaja

Regjistroni nevojat tuaja specifike ose shqetësimet dhe sillini ato në zyrë në vizitën e parë pasi t'i merrni aparatet e dëgjimit

Kjo ndihmon që audiologu t'ju japë zgjidhje për nevojat tuaja.

- \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_














Sponsori australian:  
Evertone Pty Ltd.  
15/51-53 Spring St  
Bondi Junction NSW 2022  
Australia



Dhe importuesi për Bashkimin Evropian:  
Sonova Deutschland GmbH  
Max-Eyth-Str. 20  
70736 Fellbach-Oeffingen, Germany  
Pat. [www.sonova.com/en/intellectualproperty](http://www.sonova.com/en/intellectualproperty)





Prodhuesi:  
Sonova AG  
Laubisrütistrasse 28  
CH-8712 Stäfa  
Switzerland  
[www.hansaton.com](http://www.hansaton.com)



0459

029-6726-90 V1.01/2023-08/ACC



7 613389 629248

